

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)**Buletini Nr. 261/ 2023, 27-11-2023****Parashikimi** nga 27-11-2023, ora 12:00 deri më 28-11-2023, ora 23:59.**PARASHIKIMI I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**  
-----

Nesër (e martë, dt.28) do të ketë reshje me intensitet të lartë në të gjithë territorin. Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjëndjes së kanalizimeve. Reshjet do të sjellin rritje të prurjeve në lumenjtë e mëdhenj dhe të mesëm Drin-Buna, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin dhe Vjosë.

**PARASHIKIMI METEO**  
-----**RESHJET**

Sot pasdite (e hënë, dt.27) priten reshje të dobëta.

Nesër (e martë, dt.28) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Vlorë dhe Gjirokastrë ndërsa në qarqet Dibër dhe Lezhë priten reshje intensive. Në pjesës tjetër të qarqeve reshjet priten mesatare deri lokalisht intensive. Reshjet do të shoqërohen me shtrëngata në të gjithë vendin (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

**TEMPERATURAT**

Nesër (e martë, dt.28) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 11 / 17 °C

në vendet e ulëta: 8 / 16 °C

në vendet malore: 2 / 9 °C

**ERA**

Sot pasdite (e hënë, dt.27) era pritet të jetë e lehtë deri mesatare ndërsa nesër (e martë, dt.28) era pritet të jetë mesatare deri e fortë në të gjithë vendin.

**NIVELET E RREZIKUT****S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: Florinda Tuga

Koordinator: Elona Abazi ( Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 1 / 3

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (Bulletin on Natural Hazards)













Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 261/ 2023, 27-11-2023

Parashikimi nga 27-11-2023, ora 12:00 deri më 28-11-2023, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive					
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
TIRANË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
ELBASAN	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
FIËR	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare					
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
VLORË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**


<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT**  
**për sot dhe nesër, dt. 27 – 28.**